

KOLEC TOPALLI

ALBANOLOGU I SHQUAR MARTIN CAMAJ NË 85-VJETORIN E LINDJES

Në jetën e një populli ka periudha ngritjeje, zhvillimi të vrullshëm dhe progresi të pandalshëm, por ka edhe periudha ku shfaqen forca ndaluese e penguese, që çojnë në gjymtimin dhe shformimin e jetës, të kulturës e të shkencës, për shkaqe të një logjike të mbrapshtë e absurde. E tillë qe periudha 50-vjeçare komuniste, që la në heshtje personalitete të shquara të shkencës dhe të artit shqiptar e botëror. Njëri ndër ta, viktimë e përjetshme e komunizmit, qe M. Camaj, një nga më të mëdhenjtë e letrave shqipe dhe të gjuhësisë shqiptare, 85-vjetori i lindjes së të cilit na ka mbledhur sot.

Pushteti diktatorial komunist e denigroi, e mbuloi me heshtje duke dashur që t'i harrohet emri, t'i pluhuroset vepra, të mos i njihet kontributi si atdhetar i kulluet, si mjeshtër i madh i letërsisë dhe si albanolog ndër më të shquarit. E ndërsa emigracioni shqiptar e çmonte çdo ditë e më tepër këtë vigan të letrave shqipe, prapa perdes së hekurt që ishte ngritur ndërmjet Shqipërisë dhe botës perëndimore, nuk depëronte as emri, as vepra e tij. Për këtë arsye shteti diktatorial komunist nuk mori mundimin ta shante e ta sulmonte, sepse për shqiptarët ai nuk ekzistonte. Prandaj për një gjysmë shekulli atij i mungoi lexuesi shqiptar, i mungoi frymëmarrja e atdheut, i mungoi pulsi i jetës shqiptare. E gjithë kjo luftë bëhej sepse ai mundi të dalë në botën e lirë ku zhvilloi talentin e tij të rrallë duke mbetur për gjithë jetën një shqiptar i vërtetë. Tërë jetën e tij punoi për vendin e vet, në një kohë që të gjitha fijet me të ishin të këputura dhe shteti zyrtar nuk deshi asnjëherë ta njihje kontributin e tij. Tërë jetën e tij nuk reshti së punuari për kulturën shqiptare. Qe një ambasador shetitës i një shteti, që s'e njohu kurrë për të tillë; prandaj mbeti gjithnjë i vetmuari i madh, larg tokës amë, që e deshi aq shumë.

Martin Camaj e nisi jetën më 21 korrik 1925 në familjen e një bariu të Temalit të Dukagjinit, mes bjeshkëve dhe bukurive të rralla të Shqipërisë së Veriut. Formimin e tij të parë e mori në Kolegjin Saverian të Shkodrës. Por kur diktatura komuniste e mbylli këtë institucion, i riu 20 vjeçar, i ndodhur në udhëkryqet e jetës së një shoqërie diktatoriale, përballë servilizmit politik dhe shitjes së ndërgjegjes, zgjodhi rrugën e lirisë duke u arratisur nga Shqipëria. I vetëm në një botë të panjohur, pa ndihmë e

përkrahje, ia doli mbanë vetëm me vullnetin e hekurt, energjinë e pashterrshme dhe pasionin e pakundshoq. I vendosur në fillim në Jugosllavi, u regjistrua në Universitetin e Beogradit, ku mësoi italianistikë, romanistikë, gjuhë klasike e sllavistikë, dhe nisi sprovat e para në poezi, duke gjetur rrugën e botimit në Prishtinë. Por shpejt largohet prej andej dhe vendoset në Romë, ku vijon studimet dhe mbron doktoraturën. Atje bie në kontakt me intelektualë të shquar të emigracionit me të cilët nis një bashkëpunim i frytshëm. Njëkohësisht lidhet ngushtë me diasporën arbëreshe. Me kujdesin e Ernest Koliqit, personaliteti më i spikatur i emigracionit, bëhet kryeredaktor i revistës “Shejzat”, revista më e njohur e shqiptarëve jashtë atdheut, njëkohësisht më e anatemuara nga komunizmi. Pesë vjet më vonë vendoset në Gjermani, ku pasi plotëson formimin e tij në indoeuropianistikë, caktohet profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Universitetin e Mynihut, detyrë që e kreu gjithë jetën e tij me devocion e përkushtim. Jetoj e punoi pa iu shuar asnjëherë malli i vendlindjes. Shtëpia e tij e vetmuar, ndërmjet alpeve të Bavarisë, e mbushur plot me kujtime të jetës shqiptare, i sillte në mend vendlindjen e largët, tokën e ndaluar, ku nuk mundi të kthehej asnjëherë. Ai vdiq larg atdheut, larg atyre që i kishte dashur aq shumë e për të cilët kishte punuar gjithë jetën. Mbi varrin e tij qëndron një copë shkëmb i pagdhendur, i shkukur nga vendlindja, Dukagjini i largët, që bashkëkombasit ia vunë te kryet, atij që s’mundi të prehet në atdhe dhe me gjallje të tij kishte shkruar:

*Kur të vdes le të bahem gur
në skajin e vendit tem
që qëndroj kufi.*

* * *

Martin Camaj qe shkrimtar prozator, poet e dramaturg, fusha me të cilat ai shënon një kulm në letërsinë shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Por ai qe edhe një dijetar i shquar në fushë të albanologjisë: historian i gjuhës e filolog, gramatikan e etimolog, dialektolog e mbledhës folklori, botues veprash të letërsisë së vjetër dhe kritik gjuhe. Këto janë fushat që lëvroi duke arritur në majat e kësaj shkence. Në personalitetin e tij janë bashkuar dy pole të jetës intelektuale: shkenca, që kërkon saktësi, fakte, argumente e kthjelltësi mendimi, dhe arti poetik, që kërkon fantazi e shpirt artistik. I pajisur me një kulturë e formim filologjik që mundi ta fitonte me shumë sakrifica dhe vetëm me çmimin e shtrenjtë të largimit nga vendlindja, Martin Camaj dha një shembull të shkëlqyer të bashkimit të punës së shkrimtarit e poetit krijues me atë të

dijetarit të gjuhës. Dhe sa më tepër thellohej në studimin e shqipes, aq më e pasur dhe e zhdervjellët bëhej gjuha e veprave të tij letrare.

Si gjuhëtar, Martin Camaj i nisi kërkimet shkencore me autorët e vjetër. Pas një artikulli të botuar në “Vjetarin e Institutit Ballkanologjik” më 1956, vepra më e lashtë e shkruar në gjuhën shqipe ishte objekti i punimit të doktoraturës, “Il “Messale” di Gjon Buzuku”, që u botua në Romë më 1961. Më vonë kësaj veprë iu qasën edhe dijetarë të tjerë, si: Namik Resuli, Eqrem Çabej, Selman Riza, Kolë Ashta etj., por monografia e Martin Camajt mbetet studimi i parë shkencor për tekstin më të lashtë të gjuhës shqipe. Në këtë fazë të parë të krijimtarisë së tij shkencore, Camaj e tërheqin shkrimet e hershme, me të cilat përpiqet të konturojë fazën e lashtë të shqipes në kohën kur të dy dialektet ishin më afër njëri-tjetrit. Kësaj periudhe i përket: botimi i Letrës së krerëve të Gashit, në bashkëpunim me historianin Peter Bartl, analiza e një fraze arbërishte të vitit 1483, si edhe botimi i plotë i veprës madhore “Cuneus Prophetarum” të Pjetër Bogdanit.

Në një fazë të dytë, që përkon me vendosjen në Mynih dhe me studimet e tij në indoeuropianistikë, Camaj thellohet në analizën e dukurive të lashta të shqipes me burim të trashëguar, frut i të cilave është monografia “Albanische Wortbildung” (Formimi i fjalëve në shqipe), vepër e rëndësishme e historisë së gjuhës, ku janë gërshtuar fonetika e morfologjia historike, etimologjia e fjalëformimi. Me rëndësi është fakti se ai ka studiuar parimet themelore të historisë së formimit të fjalëve, evolucionin e tyre brendagjuhësorë dhe rolin e theksit në mbijetesën e apofonisë së trashëguar. Ndër dukuri të tjera që tërhoqën vëmendjen e këtij albanologu në fushë të historisë së shqipes, veçojmë zanoret hundore në huazimet sllave, evolucionin e foljeve ndihmëse *jam* e *kam*, dhe jotizimin e bashkëtingëlloreve qiellzore, të cilat i botoi në artikuj të veçantë. Në të parin analizon refleksat e zanoreve të hundorëzuara të sllavishtes në dialektet e shqipes sipas pozicionit të tyre duke vënë në dukje edhe hundorëzimin dytësor që ka prekur gegërishten, ku kjo dukuri ka vijuar të zhvillohet për një kohë më të gjatë. Për analizat e këtyre dukurive ai gjen mbështetje edhe në toponomastikën e Veriut e të Jugut. Dukuria në fjalë vjen si vijim i një punimi më të hershëm përmbi këto zanore në veprën më të lashtë të gjuhës shqipe, të botuar në revistën “Shëjzat” më 1959.

Artikulli i dytë analizon evolucionin e dy foljeve ndihmëse të gjuhës shqipe, *jam* e *kam* duke vënë në dukje ndryshimet e tyre që nga format më të lashta me burim të trashëguar e deri në format e sotme që gjenden në të folmet e shqipes.

Në artikullin e tretë, duke analizuar shndërrimet e bashkëtingëlloreve qiellzore në sonanten e zëshme -j, Camaj arrin në përfundime me rëndësi për shtresëzimin e huazimeve latine dhe kronologjinë e hyrjes së tyre në gjuhën shqipe.

Në një fazë të tretë merret kryesisht me dialektologji arbëreshe. Dëshira për të pasur kontakte me gjuhën e gjallë, shqipen e folur, në një kohë kur portat e vendlindjes i kishte të mbyllura, e shtyu gjuhëtarin e madh drejt arbëreshëve të Italisë, që kanë ruajtur një fazë më të lashtë të shqipes, gjë që pajtohej edhe me prirjet e tij për historizëm në studimin e gjuhës. Lidhjen e ngushtë ndërmjet dialekteve dhe teksteve të vjetra ai e kishte vënë në dukje që në fillimet e studimeve të tij gjuhësore në një kumtesë të vitit 1964 në Kongresin e parë Ndërkombëtar të Dialektologjisë së Përgjithshme, të mbajtur në Luven të Belgjikës.

Në fushë të dialektologjisë, botimet e para lidhen me të folmet e vendlindjes. Të tillë janë artikujt që botoi: njëri për zhvillimet paralele në të folmet e Malit të Zi dhe të Shqipërisë Veriore, kurse tjetri për zhvillimin historik të së folmes së krahinës së Matjes. Por mungesa e kontakteve me vendlindjen bëri që ai të largohej nga të folmet e Shqipërisë për t'u afruar me të folme të tjera, ku ishte e mundshme prania e tij, në diasporën italo-shqiptare, me të cilën u lidh tërë jetën pazgjidhshmërisht. Pas një artikulli studimor për këto të folme, "Gjurmë të popullsisë shqiptare në Provincën e Piaçencës" të botuar te "Shëjzat" më 1969, vijojnë studimet "Për të folmen shqipe të Barilit në provincën e Potencës" të botuar gjermanisht në Mynhen më 1971, "Bilinguizmi në oazet gjuhësore shqipe të Italisë së Jugut", të botuar italisht në Piza më 1974; "Mbetje gjuhësore të së folmes shqipe të Vila Badesas në provincë të Peskarës", botuar gjermanisht më 1975; "Për një tipologji të arbërishtes" botuar italisht më 1983 etj. Veç këtyre, të folmeve arbëreshe u kushtoi disa studime me karakter monografik, si: "E folmja shqipe e Grëqit në krahinë të Avelinos", "E folmja shqipe e Falkonarës shqiptare në krahinë të Kozencës" dhe "E folmja arbëreshe e Shën Kostantinit shqiptar në krahinë të Potencës". Të gjitha këto punime, që shquhen për volumin e madh të punës dhe cilësinë e lartë të tyre, e vënë Camajn në radhën e parë të dialektologëve më të mirë. Punimet në fjalë janë frut i vëzhgimeve dhe studimeve disavjeçare, të kryera në pika të ndryshme ku vijon të ruhet arbërishtja. Ato përbëjnë një kontribut të mirëfilltë shkencor jo vetëm për studimet arbëreshe, por edhe për dialektologjinë shqiptare, gramatikën, historinë e gjuhës e më tej. Në to janë zbatuar metodat strukturaliste në një fushë ku mbizotëronin metodat tradicionale të përshkrimit të materialit dialektor. Studimi i këtyre të folmeve shtrihet në të gjitha sistemet e nënsistemet e gjuhës duke e

konceptuar atë si një njësi organike të mvetësishme, që funksionon si një tërësi e pandarë dhe zhvillohet në të gjitha rrafshet e saj. Glosari i mbledhur me kujdes në këto të folme përbën një fond pasurie jo vetëm për dialektologjinë arbëreshe, por edhe për gjuhën shqipe. Pikat që zgjodhi për studim, janë ndër më përfaqësueset e mjedisit arbëresh, duke hulumtuar të folme krahinash të izoluar dhe përgjithësisht konservative, që paraqesin interes të veçantë nga ana gjuhësore. Tipike për këtë është e folmja e Shën Konstantinit, ndërmjet Kalabrisë dhe Lukantias, që dallohet për karakterin e saj arkaik falë izolimit gjeografik. Dhe një punë të tillë albanologu i shquar e realizoi duke punuar në terren për dekada të tëra me vullnet dhe energji të pashembullt, duke mos e hequr punën nga dora as në ditët e vështira të sëmundjes së tij të rëndë, që i mori jetën. Përtej dialektologjisë arbëreshe, ai është marrë edhe me tipologjinë e të folmeve të Kosovës dhe me aspekte të plurilinguizmit të asaj pjese të arbëreshëve që ishin vendosur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Fusha të tjera ku Camaj ka dhënë kontribute me vlerë si albanolog, janë etimologjia, gramatika e sotme, folklori dhe kritika gjuhësore.

Si historian i gjuhës shqipe, në shumë studime të tij është marrë edhe me etimologji, veçanërisht në veprën “Formimi i fjalëve në gjuhën shqipe”. Krahas kësaj, ai ka botuar edhe studime të veçanta në këtë fushë, siç janë analizat etimologjike për emërtimet e farës dhe të frutave, për emrat *bjeshkë*, *vërri*, *pluhun* etj.

Fushë tjetër me kontribute të çmuara është gramatika. I bindur në vlerat që kishte një libër mësimi për gjuhën shqipe, më 1969 botoi gjermanisht librin “Lehrbuch der albanischen Sprache” (Libër mësimi për gjuhën shqipe), të cilin e plotësoi më vonë me vëzhgime, argumente dhe materiale të reja, dhe e botoi anglisht nën titullin “Albanian Grammar” (Gramatikë e shqipes), njëra nga më të mirat në llojin e saj. Ndryshe nga gramatikat e botuara, që mbështeteshin përgjithësisht tek njëri dialekt, gramatika e Martin Camajt është vërtetë gramatikë e shqipes, ku janë përfshirë pasuritë gramatikore të gegërishtes, toskërishtes dhe arbërishtes. Ajo shquhet për shpjegime të hollësishme, argumente të sakta dhe shembuj të shumtë. Është një model për t’u ndjekur.

Fushë tjetër është folkloristika. Ai ka mbledhur shumë materiale nga goja e popullit, që i kanë shërbyer për hartimin e monografive dhe janë botuar bashkë me studimet për të folmet arbëreshe. Krahas këtyre, ka botuar edhe materiale të mirëfillta dhe studime folklori, siç janë: “Tregime popullore të Gréqit në krahinë të Avelinos e të Barilit në krahinë të Potencës”, “Përralla shqiptare” në bashkëpunim me Uta Schier-Oberdorffer, “Mbi elementin e këngëve popullore në rapsoditë e Zef

Skirroi”, “Një këngë italo-shqiptare nga cikli i Skënderbeut”, “Pasqyrimi i kanunit të Lekë Dukagjinit në epikën popullore shqiptare”, “Shënime kanunave të Mirditës” etj.

Së fundi, kritika gjuhësore. Ashtu si Norbert Jokli në vitet '30, që mbajti gjallë bibliografinë e studimeve gjuhësore të shqipes, edhe Martin Camaj ka kaluar në sitën e kritikës veprat kryesore të botuara në fushë të albanologjisë. Lista e emrave të gjuhëtarëve dhe e veprave të recensionuara është e gjatë. Po përmendim vetëm disa prej tyre, emra të njohur në fushë të albanologjisë: Jeronim de Rada, Carlo Tagliavini, Petar Skok, Vaclav Polak, Klaus Hebler, Eqrem Çabej, Karl Gurakuqi, Arshi Pipa, Ivan Popović, Idriz Ajeti, Giuseppe Ferrari, Agnija Desnickaja, Francesco Solano, Antonino Guzzetta, Marco Gabinski, Norbert Boretzky, Armin Hetzer, Gerard Rohlfs e të tjerë.

Ky është në vija të përgjithshme kontributi albanologjik i Martin Camajt, i këtij dijetari të palodhur të gjuhës që arriti majat e shkencës shqiptare, njëri nga kolosët e letrave shqipe, që tërë jetën punoi për lëvrimin e saj, me bindjen se: “Gjuha shqipe është pasunia më e madhe shpirtnore që kemi. Në të përmbahet përvoja dhe ditunia e popullit tonë, në të qëndron rruajtja dhe shpëtimi i individualitetit të tij”.

Ai u nda prej nesh atëherë kur u shqimb prej kësaj toke një herë e përgjithmonë makina vrastare e komunizmit, që e la tërë jetën pa atdhe. Por ai na la veprën e tij monumentale, të përkryer, të paçmuar. E shkruar pjesërisht në shqipe dhe pjesërisht në 4 gjuhë të huaja, e botuar në vendet ku endej në mërgim, vepra e tij ka nevojë të mblidhet, të kthehet në gjuhën me të cilën e mendoi dhe e krijoi, dhe të fitojë atdhesinë që iu mohua. Le të shpresojmë.